

NË EMËR TË POPULLIT

P. nr.439/2017

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Rrahman Beqiri, me procesmbajtëse Selvije Kostërci, në lëndën penale ndaj të pandehures K.S. nga ..., për shkak të veprës penale: Shkelja e urdhrit mbrojtës nga neni 25 lidhur me nenin 18 par. 1 pika 1.2 të Ligjit nr. 03/L-182 për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, duke vendosur sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.511/2017 të datës 06.07.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt. 16.01.2019 në praninë e Prokurorit të Shtetit Natasha Radoviq dhe të pandehures, me datë 17.01.2019 publikisht shpalli, ndërsa me datë 23.01.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara:

K.S., nga i ati ..., e ëma ..., e vajzërisë ..., e lindur me dt. ... në ..., Republika e ..., tani me vendbanim në ..., Rr, “...” nr. ..., teknike e dhëmbëve, ka të kryer shkollën e lartë, e gjendjes së mesme ekonomike, serbe, shtetase e Kosovës.

ËSHTË FAJTORE

SEPSE:

Me datë 01.07.2017, në ..., e pandehura e ka thyer urdhrin mbrojtës të lëshuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë, sipas Aktvendimit C.nr.138/2017 të datës 04.04.2017, me të cilin është aprovuar kërkesa e palës së mbrojtur dhe është obliguar e pandehura që të përmbajet nga çfarëdo shqetësimi, i cili do të nënkuptonte këto veprime: përdorimin e forcës fizike apo presionit psikik, si dhe i është caktuar që fëmijun e tyre të mitur E.A., një herë në javë – çdo të shtunë, në afërsi të shtëpisë së prindërve të palës së mbrojtur në ..., nga ora 11:00 deri në ora 15:00 të ia dërgojë vajzën për kontakt, të dëmtuarit G.A., e ku e pandehura tre herë radhazi – tri të shtunë nuk ia ka sjellë të dëmtuarit vajzën, siç është paraparë me vendimin e gjykatës.

Me këtë ka kryer veprën penale: Shkelja e urdhrit mbrojtës nga neni 25 lidhur me nenin 18 par. 1 pika 1.2 të Ligjit nr. 03/L-182 për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje.

Andaj Gjykatat në baze të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 45, 46, 49, 50, 51,52, 73 të KPRK-se, dhe nenit 450, 460 të KPP-së, i:

S H Q I P T O N

I.DËNIM ME GJOBË në shumën prej 400 (katërqindë euro), të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej tre (3) muajve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. OBLIGOHET e pandehura K.S., që t'i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe atë, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumë prej 30€, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil-juridik.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.511/2017 të datës 06.07.2017, K.S. nga ..., për shkak të veprës penale: Shkelja e urdhrit mbrojtës nga neni 25 lidhur me nenin 18 par. 1 pika 1.2 të Ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar ashtu që në këtë seancë e pandehuri: e ka pranuar fajësinë, duke theksuar se e ndjej veten fajtor, se e kuptoj natyrën dhe pasojat juridike të pranimin të fajësise, shprehi keqardhje për krejt këtë, tani me raportet që një vit e më shumë janë rregulluar, nuk kemi probleme sa i përket zbatimit të vendimit të gjykates në lidhje me kontaktet me femijën, dhe i premtoj gjykates që nuk do të ndodh ky veprim në të ardhmen.

Prokurori, lidhur me pranimin e fajësisë ka dhënë mendimin: konsideroj se janë plotësuar kushtet ligjore që gjykata të pranojë pranimin e fajësise, se e pandehura pendohet për kryerje të veprës penale, se vepra nuk është perseritur, po ashtu kemi të bëjmë me një person të moshasës së re si e pandehur. Dhe krejt këto me rastin e vendosjes të merr parasysh gjykata si rrethana lehtësuese.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar e pandehura K.S., e në mbështetje të nenit 248 të KPP-ës, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurën. Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehures, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykate si: Deklarata e të pandehures K.S. dhënë në polici, e datës 01.07.2017; Deklarata e të dëmtuarit G.A. e dhënë në polici, e datës 01.07.2017; Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë C.nr.138/2017 dt.04.04.2017; Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues që në bazë të tyre dhe pranimin të fajësisë, konsiderojmë se për tej çdo dyshimi është vërtetuar se e pandehura K.S., ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehures është bërë në mënyrë vullnetare, se e pandehura ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, duke i'u tërhequr vërejtja të pandehures se pas pranimin të fajësisë, ajo nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga e pandehura K.S.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të pandehures K.S. dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se e pandehura ka kryer veprën penale: Shkelja e urdhrit

mbrojtës nga neni 25 lidhur me nenin 18 par. 1 pika 1.2 të Ligjit nr. 03/L-182 për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje.

Sipas Ligjit nr. 03/L-182 për këtë veprë penale është paraparë dënimi me gjobë prej dyqindë (200) deri në dymijë (2000) euro ose dënim me burg deri në gjashtë (6) muaj.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit ne mbështetje të nenit 73 të KPK-ës. Si rrethana rënduese ka gjetur shkallen e përgjegjësisë penale gjë që nga provat rezulton se e pandehura këtë veprë e kishte kryer me dashje. Si rrethanë lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë për veprën penale, faktin se e njëjta ka shprehe keqardhje dhe është penduar për ndodhjen e rastit, duke premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë sjelljet e njëjta, sjellja korrekte e të pandehures në gjykatë, ne raport me gjykatë dhe palët, dhe se nga deklarimi në seancë, tani vazhdon që të respektohet Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë C.nr.138/2017 dt.04.04.2017 dhe se tani kontaktet mbahen rregullisht sipas këtij deklarimi.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore gjykata ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, duke vlerësuar se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 par. 1 të KPRK-së, që ti parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.6 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensim viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05\L-036 per Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Për sa i përket kërkesës pasurore-juridike gjykata ka udhëzuar ne konteste te rregullt civil, në kuptim të nenit 463 të KPP-së..

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 365, 450, 453 te KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.439/2017 dt.23.01.2019

Procesmbajtësja:
Selvije Kostërci

Gjyqtari

Rrahman BEQIRI

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjyaktës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.